

VENDIM
Nr.339, datë 1.6.2004

**PËR SISTEMIMIN ME MJEDISE PUNE TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e studios lëvizëse dhe të ateliesë së piktorëve të Radiotelevizionit Shqiptar, së bashku me truallin funksional, në përdorim të këtij institucioni, në rrugën “Abdi Kazani”, në Tiranë, sipas genplanit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Integritimit European.

2. Prona me numër rendor 72, “Sh.a. Elektronika e ushtrisë”, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, sipas genplanit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, dhe t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.


3. Mjediset, që aktualisht i ka në përdorim Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, në bulevardin “Zogu I”, pas rikonstruksionit të mjediseve të shoqërisë anonime “Elektronika e ushtrisë”, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Komitetit Shtetëror për Kultet.

4. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Koordinimin, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Integritimit European, Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar, kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi nr.47, datë 22.1.2004 i Këshillit të Ministrave “Për sistemimin me mjedise të disa institucioneve shtetërore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



Plani No 1

RR. "LEK DUKAGJINI"

EKSTRAKT NGA PLANIMETRIA
E QYTETIT TE TIRANES

SH. 1:500

Adm. A. Shireli

